




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.Nr.175/2021
Datë: 23 qershor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Bekim Avdimetaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan, duke vendosur sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/02/2021/GJTHPE-ADGJTHPE.nr.03/2021, të datës 20 maj 2021, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore, të mbajtur me 23 qershor 2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Bekim Avdimetaj**, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Deçan, është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.2 dhe 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
2. Për këtë shkelje disiplinore Gjyqtarit Bekim Avdimetaj i shqiptohet sanksion disiplinor **vërejtje publike me shkrim**.

A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.70/2021, të datës 24 mars 2021, për lëndën disiplinore me numër Nr.AD/KGJK/02/2021/GJTHPE-AD/GJTHPE.nr.03/2021, të datës 17 maj 2021, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkelje disiplinore të pretenduara të Bekim Avdimetaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan. Sipas pretendimit të Autoritetit Kompetent Gjyqtari Bekim Avdimetaj ka bërë shkelje disiplinore duke bartur lëndët C.nr.129/2018, C.nr.260/2017, C.nr.12/2012, C.nr.96/2017, C.nr.229/2007, C.nr.29/2015, C.nr.115/2014 nga zyra e tij në tek zyra e gjyqtarit Nexhat Musaj.

Për ta shqyrtuar këtë çështje disiplinore KGJK me 23 qershor 2021, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore ku morën pjesë Kryesuesi i Panelit Hetimor Gjyqtari Alush Sinani dhe subjekti i hetimit disiplinor.

Kryesuesi i Panelit Hetimor në fjalën hyrëse dhe përfundimtare ka deklaruar se zhvillimi i hetimit disiplinor është bërë në bazë të një shkresë të dërguar nga mbikëqyrësi i Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Deçan të Kryetari i Gjykate Themelore në Pejë, duke pretenduar se Gjyqtari Bekim

Avdimetaj lëndët me numër C.nr.129/2018, C.nr.260/2017, C.nr.12/2012, C.nr.96/2017, C.nr.229/2007, C.nr.29/2015, C.nr.115/2014, në mënyrë të pa arsyeshme i ka bartur nga zyra e vet tek zyra e ish gjyqtarit Nexhat Musaj, si dhe nuk kishte ndërmarr asnjë veprim konkret në drejtim të zgjidhjes së tyre me qëllim të përfundimit brenda afatit kohor të arsyeshëm. Me tutje, Kryesuesi i Panelit Hetimor deklaroj se në bazë të shkresave të lëndës, provave të mbledhura dhe procesverbalit të deklarimit të subjektit të hetimit është vërtetuar fakti se në mes të datave 25 dhe 26 janar 2021, nga zyra e Gjyqtarit Bekim Avdimetaj, janë bartur lëndët e lartë cekura në zyrën e gjyqtarit Nexhat Musaj, po ashtu është vërtetuar se të njëjtat lëndë sipas kërkesës së vet gjyqtari Avdimetaj janë kthyer prapë në zyrën e tij me datë 29.01.2021, fakt i cili është vërtetuar me emalin e datës 29.01.2021. Kryesuesi i Panelit Hetimor ka kërkuar nga KGJK që në bazë të fakteve dhe provave të mbledhura të vendos që në veprimet e gjyqtari Bekim Avdimetaj a ka apo nuk ka shkelje disiplinore si ka pretenduar Autoriteti Kompetent.

Subjekti i hetimit disiplinore gjyqtari Bekim Avdimetaj, në seancë dëgjimore ka deklaruar se është e vërtet që lëndët i ka bartur nga zyra e tij në zyrën e gjyqtarit Nexhat Musaj, dhe bartjen e ka për përmes smilit, por edhe në kopje fizike. Arsye për këtë bartje gjyqtari Bekim Avdimetaj ka theksuar se ka qenë konsultimi me gjyqtarin Musaj, pasi që kanë qenë lëndë komplekse dhe gjyqtari Musaj ka qenë me më përvojë. Të njëjtat lëndë ishin kthyer sipas kërkesës në zyrën e tij me datë 29.01.2021.

Për ta vërtetuar këtë çështje KGJK administroi dhe vlerësoj këto prova: Aktvendimi i GJTHPE-dega në Deçan NR. C.nr.115/14 i datës 31.10.2016 me të cilin është tërhequr padia; Aktvendimin i GJTHPE dega në Deçan NR. C.nr.260/17 i datës 26.07.2018 me të cilin është tërhequr padia; Email dërguar nga referenti i GJTHPE-dega në Deçan [] i zyrtarë për informim dhe monitorim të mediave nga i cili kërkohet të barten katër lëndët nga Gjyqtari Bekim Avdimetaj të Gjyqtari Nexhat Musaj, data 22.01.2021; Emalin nga Gjyqtari mbikëqyrës i GJTHPE-dega në Deçan Sulltan Dobraj dërguar [], Bekim Avdimetaj, [] j njoftim për ndarjen e lëndëve, datë 28.01.2021; Emalin nga Gjyqtari Mbikëqyrës i GJTHPE-dega në Deçan Sulltan Dobraj dërguar Gjyqtarit Bekim Avdimetaj lidhur me kërkesën për sqarim të bartjes së lëndëve nga zyra e Gjyqtarit Avdimetaj në zyrën e [], data 28.01.2021; Emalin dërguar nga Gjyqtari Bekim Avdimetaj Gjyqtarit Mbikëqyrës të GJTHPE-dega në Deçan Sulltan Dobraj, data 29.01.2021; Raportin me shkrim lidhur me katër lëndë i datës 29.01.2021; Emalin dërguar nga referenti i GJTHPE-dega në Deçan [] zyrtarë për informim dhe monitorim të mediave lidhur me bartjen e katër lëndëve nga Gjyqtari Nexhat Musaj te Gjyqtari Bekim Avdimetaj, data 02.02.2021; Emalin dërguar nga Gjyqtari Mbikëqyrës i GJTHPE-dega në Deçan [] Kryetari i GJTHPE Armend Berisha lidhur me bartjen e lëndëve nga Gjyqtari Bekim Avdimetaj, data 02.02.2021; Njoftimin e Kryetarit të GJTHPE Armend Berisha për KGJK-në lidhur me fillimin dhe vlerësimin e provave për shkelje të mundshme disiplinore nga ana e Gjyqtarit Bekim Avdimetaj, data 03.02.2021; Emalin e dërguar nga Zyrtarja për informim dhe monitorim të mediave [] dërguar Gjyqtarit Bekim Avdimetaj nga i cili kërkohet të dhënat se kur është ngarkuar me shtatë lëndë, data 03.02.2021; Emalin e dërguar nga gjyqtari Bekim Avdimetaj zyrtarë për informim dhe monitorim të mediave [] i Lidhur me bartjen e lëndëve ndërsa për lëndën C.nr.260/2017 njofton se nuk e ka në zyre dhe nuk e ka bartë, data 05.02.2021; Vendimi i GJTHP nr. A.D.nr3/21 i datës 08.02.2021 për formimin e komisionit AD - HOC me qëllim të vlerësimit të ngarkesës me lëndë të Gjyqtarit Bekim Avdimetaj;

Emalin dërguar nga Gjyqtari Sulltan Dobraj Mbikëqyrës në GJTHPE-dega në Deçan te Kryetari i GJTHP Armend Berisha lidhur me disa pohime të Gjyqtarit Avdimetaj me kundërshtimet e gjyqtarit Dobraj të pohimeve të Gjyqtarit Avdimetaj, data 22.02.2021; Emalin dërguar nga Gjyqtari Avdimetaj Kryetarit të GJTHPE Armend Berisha reagim ndaj një pjese të emalit dërguar Kryetarit të GJTHPE nga Gjyqtari Mbikëqyrës Sulltan Dobraj, data 23.02.2021; Emalin dërguar

nga Gjyqtari Bekim Avdimetaj Kryetarit të GJTHPE Armend Berisha lidhur me natyrën e punës të zyrës Gjyqtarit Avdimetaj, data 24.02.2021 ; Email dërguar nga Arben Haskaj Shef i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve Kryetarit të GJTHPE Armend Berisha të cilin e njofton lidhur me të gjeturat e komisionit AD-Hoc për lëndët të cilat ishin pranuar nga Gjyqtari Avdimetaj gjithsej shtatë lëndë, data 25.02.2021; Emalin nga _____ për informim dhe monitorim të mediave në GJTHPE dërguar _____ lidhur me sigurimin e pasqyrës së lëndëve të kryera ndër vite nga Gjyqtari Avdimetaj, data 26 shkurt 2021; Emalin dërguar nga Gjyqtari Bekim Avdimetaj Kryetarit të GJTHPE Armend Berisha dhe Mbikëqyrësit Gjyqtarit Sulltan Dobraj lidhur me njoftimin për bartjen e lëndëve, datë nuk ka; Njoftimin e Kryetarit të GJTHPE Armend Berisha lidhur me ndarjen e lëndëve të Gjyqtarit Nexhat Musaj te Gjyqtari Bekim Avdimetaj në punë; Njoftimin e Kryetarit të GJTHPE Armend Berisha lidhur me ndarjen e lëndëve të Gjyqtarit Bekim Avdimetaj te Gjyqtari Nexhat Musaj në punë; Lista e bartjes së lëndëve nga sistemi Smil te Gjyqtarët; Emalin e dërguar nga Gjyqtari Bekim Avdimetaj me datë 06.05.2021, zyrtares _____ me qellim njoftimi se me datë 29.01.2021, lëndët kontestuese me datë 29.01.2021, i janë kthyer në zyre nga gjyqtari Nexhat Musaj përmes Smilit; Procesverbali i panelit hetimor i datës 16.04.2021; Procesverbali-transkripti i panelit hetimor i datës 05.05.2021.

Pas vlerësimit të këtyre provave një nga një dhe të gjitha së bashku, KGJK konstatoi se gjyqtari Bekim Avdimetaj ka bërë shkeljen disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.2 dhe 2.7, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve sepse me datë 25-26.01.2021 ka bërë bartjen e lëndëve C.nr.129/2018, C.nr.260/2017, C.nr.12/2012, C.nr.96/2017, C.nr.229/2007, C.nr.29/2015, C.nr.115/2014, nga zyra e tij në zyrën e Gjyqtarit Nexhat Musaj përmes sistemit smil dhe në kopje fizike. KGJK konstatoj se kjo bartje e lëndëve ishte bërë nga referenti i gjykatës sipas kërkesës së gjyqtarit Avdimetaj, ku sipas rregullores bartja e lëndëve nga një gjyqtar tek tjetri bëhet vetëm me vendim prej Kryetarit të Gjykatës, që në rastin konkret nuk ka ekzistuar një vendim i tillë.

KGJK ka konstatuar se është vërtetuar me prova se lëndët janë kthen në zyrën e gjyqtarit Avdimetaj me datë 29.01.2021, mirëpo ky kthim i lëndëve konkrete në zyrën e Gjyqtarit Avdimetaj ishte bërë pasi që Gjyqtari Mbikëqyrës Sulltan Dobraj kishte kërkuar nga Gjyqtari Avdimetaj sqarim lidhur me këtë bartje.

KGJK vlerëson se sjelljet e gjyqtarit Bekim Avdimetaj në rastin konkret janë shkelje disiplinore e përcaktuar në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.2 dhe 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

KGJK i shqyrtoj me kujdes masat disiplinore të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe vlerësoj se në rastin e Gjyqtarit Bekim Avdimetaj masa **vërejtje publike me shkrim** është masë proporcionale në raport në shkeljen e bërë të gjyqtarit dhe se e njëjta do të shërbej si mase për disiplinimin e gjyqtarit dhe si preventive për të ardhmen.

Nga sa u tha me lartë, konform nenit 7, paragrafi 1, pika 1.2, dhe paragrafi 2, pika 2.1, 2.4, dhe 2.5, të Ligjit nr.06/l-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.Nr.175/2021, datë: 23 qershor 2021

Skender ÇOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejt ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Armend Berisha, Kryetar në Gjykatën Themelore në Pejë;*
- *Bekim Avdimetaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Deçan;*
- *Arkivit.*